

20252204302

Në bazë të nenit 61 paragrafit (9) të Ligjit për Arsimin e Mesëm (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 229/20, 78/25 dhe 132/25), ministri i Arsimit dhe Shkencës solli:

PROGRAM PËR DHËNIEN E PROVIMIT PROFESIONAL PËR EDUKATOR NË SHKOLLË TË MESME ME KONVIKT PËR NXËNËS

Neni 1

Me këtë program përcaktohen fushat dhe temat për dhënie e provimit profesional për edukator në shkollë të mesme me konvikt për nxënës.

Neni 2

Fushat dhe temat për dhënie e provimit profesional për edukator në shkollë të mesme me konvikt nxënësish janë si vijon:

Tema nga fusha: Edukimi fizik dhe shëndetësor

- nxitja e aktivitetit fizik të rregullt të nxënësit përmes futjes së ushtrimeve të shkurtra ditore në konviktin e nxënësve,

- roli i edukatorit në krijimin e zakoneve të shëndetshme të jetesës përmes sportit dhe lëvizjes,

- zhvillimi i kulturës së higjienës personale dhe zakoneve të shëndetshme të nxënësit në konvikt,

- ndikimi i aktiviteteve sportive në grup mbi marrëdhëniet ndërpersonale dhe shpirtin e punës në ekip të nxënësit,

- parandalimi i mënyrës së jetesës sedentare përmes futjes së lëvizjeve të shkurtra dhe pushimeve aktive para orëve të mbrëmjes për mësim,

- motivimi i nxënësve për pjesëmarrje në aktivitete sportive dhe rekreative përmes shpërblimeve dhe programeve stimuluese.

Temat në këtë fushë: Zhvillimi intelektual

- përmirësimi i përqendrimit dhe vëmendjes së nxënësve përmes futjes ushtrime të shkurtra fokusi para orëve të studimit në mbrëmje,

- ndikimi i bisedave motivuese me edukatorin në motivimin akademik të nxënësve,

- zhvillimi i të menduarit krijues tek nxënësit përmes aktiviteteve dhe projekteve në grup në konviktin e nxënësve, dhe

- krijimi i mjedisit pozitiv mësimor në konviktin e nxënësve përmes organizimit të grupeve shkollore dhe mbështetjes nga edukatori.

Tema nga fusha: Edukimi moral dhe estetik

- zhvillimi i përgjegjësisë dhe solidaritetit të nxënësit përmes aktiviteteve edukative në grup në konviktin e nxënësve,

- promovimi i sjelljes etike dhe respektimit të rregullave përmes bisedave edukative dhe lojërave për zgjidhjen e konflikteve.

- ndikimi i aktiviteteve estetike në zhvillimin e kreativitetit dhe shprehjes personale të nxënësit,

- zhvillimi i vetëdijes kulturore dhe respektit ndaj traditave përmes ngjarjeve të përbashkëta kulturore,

- nxitja e tolerancës dhe respektit të ndërsjellë përmes debateve edukative dhe projekteve në grup, dhe

- roli i edukatorit në formimin e vlerave pozitive estetike përmes organizimit të ekspozitave dhe prezantimeve të veprave të nxënësve.

Tema nga fusha: Edukimi për punë dhe puna me dobi shoqërore

- përmirësimi i përgjegjësisë dhe bashkëpunimit të nxënësit përmes organizimit të detyrave të përbashkëta shtëpiake dhe aktiviteteve në konviktin e nxënësve,

- nxitja e ekologjisë dhe ndërgjegjes mjedisore përmes aksioneve me dobi shoqërore në konvikt dhe në komunitet,

- roli i edukatorit në motivimin e nxënësve për pjesëmarrje në projekte me dobi shoqërore,

- zhvillimi i pavarësisë dhe aftësive organizative të nxënësit përmes udhëheqjes në projekte brenda konviktit,

- promovimi i vlerave të punës dhe iniciativës përmes realizimit të projekteve praktike dhe punimeve dorëzanë, dhe

- ndikimi i pjesëmarrjes së rregullt në aktivitete me dobi shoqërore në disiplinën dhe përgjegjësinë të nxënësit.

Tema nga fusha: Edukimi qytetar

- zhvillimi i ndjenjës për përgjegjësi qytetare të nxënësit përmes pjesëmarrjes në projekte të përbashkëta lokale,

- nxitja e respektimit të rregullave dhe normave në konviktin e nxënësve si bazë për sjellje qytetare,

- zhvillimi i tolerancës dhe respektit ndaj diversiteteve përmes aktiviteteve edukative në konvikt,

- ndikimi i edukatorit në formimin e të menduarit kritik dhe marrjen e vendimeve të përgjegjshme të nxënësit,

- nxitja e pjesëmarrjes në komunitet përmes organizimit të aktiviteteve kulturore dhe humanitare, dhe

- edukimi për të drejtat dhe liritë e njeriut përmes aktiviteteve edukative në konviktin e nxënësve.

Neni 3

Kjo program hyn në fuqi ditën e nesërme pas ditës së publikimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.

Nr. 18- 13599/1

24.10.2025

Shkup

Ministre e Arsimit

dhe Shkencës,

Pr. Dr. **Весна Јаневска**, d.v.